

Njoftim për shtyp

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), z. Altin Dumani, në ushtrim të kompetencës së Komisionerit Publik, autorizoi z. Klodjan Braho, me funksion Prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, (njëkohësisht Drejtuesi i Seksionit Kundër Korrupsionit), për ta përfaqësuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor të ankimit kundër vendimit nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Hysni Mulaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Gjatë verifikimit të prezencës, kryesuesja e trupit gjykues bëri me dije se palët ishin vënë në dijeni mbi parashtrimet që do të referojnë në seancë dhe një qëndrim të mbajtur nga subjekti i rivlerësimit mbi një denoncim nga publiku.

Drejtuesi i Seksionit Kundër Korrupsionit në Prokurorinë e Posaçme z. Klodjan Braho, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit, çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe për rrjedhojë, nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, sipas parashikimeve të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Në përmbyllje të parashtrimeve të tij, z. Braho kërkoi nga trupit gjykues, që në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, të ndryshojë vendimin nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Mulaj.

Subjekti i rivlerësimit, përmes përfaqësueses ligjore, pretendoi për të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe në mbështetje të prapësimeve, kërkoi riçeljen e hetimit dhe administrimin e provave të reja. Subjekti i rivlerësimit iu përgjigj edhe disa pyetjeve të adresuara nga relatorja e çështjes, si dhe nga vëzhguesja ndërkombëtare.

Në vijim, palët referuan qëndrimet mbi denoncimin nga publiku. Drejtuesi i Seksionit Kundër Korrupsionit në Prokurorinë e Posaçme vlerësoi se në ankesë nuk paraqiten rrethana të vlefshme për këtë fazë të procesit. Ndërsa subjekti i rivlerësimit u shpreh se i qëndronte shpjegimeve me shkrim të depozituara në Kolegj.

Trupi gjykues, pas konsultimit në dhomë këshillimi, vendosi të çelë hetimin dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe ftoi palët të përgatiten për paraqitjen e bisedimeve përfundimtare, në seancën e datës 7.4.2025, ora 14:00.

Ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të SPAK-ut, në rubrikën “Procesi i rivlerësimit”:
<https://spak.gov.al/>

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë, që prej datës 1.1.2025.